

INTERVISTË ME ALIJE GASHI TMAVA

Mitrovicë | Data: 21 mars, 2022

Kohëzgjatja: 62 minuta

Të pranishëm:

1. Alije Gashi Tmava (e Intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Alije, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu pak diçka për jetën, fillimisht biografinë t'shkurtër dhe për prejardhjen e ju, familjen?

Alije Gashi Tmava: Unë quhem Alije Gashi Tmava e lindur në Mitrovicë me 09. 03. '62. në vitin 1981 kam qenë brucoshe, në '85-tën jom punësu në Kombinatin Miniera me Flotacion Trepçë.

Anita Susuri: Qysh e kujtoni ju jetën familjare si fmi? Çfarë familje keni qenë?

Alije Gashi Tmava: Unë, e thashë, kam lindë në Mitrovicë, gjeneza ime është, gjeneza ime është në Klinë të Mesme, Mecin i Klinës. Gjyshi m'ka lindë në fshat, gjyshja m'ka lindë në Mitrovicë. Qysh atëherë gjyshën e kom pasë ni femën të shkollume. Ka kry edhe, ka kry gjimnaz në gjuhën serbo-kroate, si dhe ka marrë, ka kry hatme, thuheste tash në shkollat medrese e kështu.

Anita Susuri: A mundeni pak ma shumë me na tregu për qit', çfarë familje kanë qenë ato, për shembull, gjyshës t'juj? Ka qenë e rrallë atëherë me u shkollu...

Alije Gashi Tmava: Po, në kohën e... gjatë Luftës së Dytë Botërore në '43-tën muj t'them, '45-tën, gjyshi zinët rob. Kur ne e dijmë që atëherë osht' nda, osht' nda me pjesë, me fshatra gjermantë, italiantë edhe zihët rob. Gjyshja mbetë me tre fmi të vegjël. Atëherë, ajo shkon në, atëherë i kanë thanë se ashtu qysh u shprehke gjyshja, në komunë, tha, "Moj nanë shkova në opshtinë¹", edhe tha, "e bona ni kërkesë. Ni mollbë²", tha, "e shkruva", tha.

Ni person i joni që kanë qenë ndihmës të pushteteve t'ndryshme thotë, "A sen *arnautka* [trq.: A ti je shqiptare], qysh po din? A po din me shkru?" Kjo i ka thonë, "A t'shkruj? A po don me shkru çirlicë, a po don me shkru turqisht?" "Jo", ka thonë, "Shkruje" [në turqisht] *yaz, yaz* është me shkru. Thotë, "Shkruje", thotë, "kërkesën, Kryqit të Kuq". Gjyshja u shprehke *Crveni Krstit* [srb.: Kryqi i Kuq] që e kërkon bashkëshortin. Mandej ato kërkesa kanë dalë jashtë Kosove. Atëherë edhe kthehet gjyshi mas

¹ Srb. *opština*, në përkthim komunë.

² Srb. *molba*, në përkthim kërkesë.

tri viteve që ka qenë rob. Kthehet në Mitrovicë e vazhdon jetën. Kështu që, baba im ka qenë vet i teti, domethonë tre vllazën dhe pesë motra.

Anita Susuri: E gjyshi ju j çka ka tregu për atë kohën? A ju kujtohet, që ka qenë i zanun rob?

Alije Gashi Tmava: Po. Gjyshi ka folë shumë pak se ka qenë edhe koha që ai s'ka dashtë m'u ekspozu, se njiherit ka qenë edhe bashkëluftëtar i Azem Bejtës. Ka qenë Lufta e Drenicës, kaçake³ që ka qenë, [ajo luftë] ka qenë aty. Ku ai ka qenë vet i gjashti vlla edhe disa vllazën iu kanë vra në atë luftën kaçake. Ai e jeton jetën në Mitrovicë, në lagjën Bajr ku edhe aty jena kështu dem baba dem. Ka 150 vite që jem aty, se gjyshi edhe ai m'ka jetu shumë gjatë, po nuk ka deshtë shumë me folë për biografinë. Pak para se me vdekë ka tregu. "Pse nuk ke tregu ma herët?" "Jo se sistemi ka qenë i atillë". Kështu që, nuk ka deshtë se ato pengesat kanë qenë nacionaliste, jonë përcjellë. Kanë mendu që fëmitë tana nuk mujnë me vazhdu m'u shkollu.

Anita Susuri: Thatë për gjyshen e ju j edhe niherë po m'duket shumë interesante, çfarë familjes i ka taku ajo? A ka qenë familje e vjetër qytetare, a ka qenë?

Alije Gashi Tmava: Po edhe gjyshja e ka pasë t'njeitin fat, ajo ka lindë, osht' rritë, edhe ajo e ka gjenezën prej fshatit Likovc. Ajo ka qenë faktikisht fëmi i qytetit. Kur i ka zotëru, tri gjuhë i ka zotëru edhe ata shkrim e lexim ka shkru... shqip nuk ka shkru se s'kem pasë mundësi n'atë kohë, s'ka qenë gjuha jonë. Domethonë, turqishten edhe shqipen i ka shkru, i ka lexu, krejt. Gjyshi s'ka pasë shkrim lexim, se u kanë njeri i malit, i luftës. Gjyshja ka shkru për to.

Anita Susuri: E baba i gjyshës, kështu, stërgjyshi ju j me çka osht' marrë?

Alije Gashi Tmava: Jonë marrë zakonisht në Mitrovicë me bujqësi, kurse gjyshi im osht' marrë me ndërtimtari edhe e ka vazhdu jetën, ka punu osht' punësu në kohën e... Mas anglezëve osht' punësu në Zveçan edhe aty e merr ni pension invalidor edhe vazhdon punon në ndërtimtari.

Anita Susuri: N'familjen e ju j sa vllazër e motra jeni? Sa fmi jeni?

Alije Gashi Tmava: Ne jemi, kem qenë tri motra unë e treta motër edhe tre vllazër. Domethonë, vllau ma i vogël bie në altarin e lirisë bie dëshmor me 26 shkurt 1999, mrapa e len bashkëshorten edhe vajzën e kështu.

Anita Susuri: Po m'intereson, a ju kujtohet baba ju j, po thoni që ka punu në Trepçë, a ju kujtohet periudha kur ka punu ai?

³ Lëvizja kaçake lindi si formë e rezistencës kundër pushtuesit të huaj. Me këtë emër njihet në periudhën turke në shekullin XV-XVI, e cila kishte më tepër karakter ekonomik sesa politik. Kjo lëvizje vjen duke u shtuar gjithnjë e më tepër merr formën e rezistencës politike në truallin shqiptar, posaçërisht në gjysmën e dytë të shekullit XIX e bëhet më masive pas shuarjes së Lidhjes së Prizrenit.

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për shembull? Qysh osht' kthy n'shpi? N'çfarë gjendje? A ka pasë ndonjë trajtim ma t'veçantë si punëtor i minierës?

Alije Gashi Tmava: Ato vite kur osht' punësu baba, se kem qenë shumë t'afërt me babën domethonë, ka punu shumë me ne. Në vitet e '60-ta ka qenë një kohë shumë e ashpër për shqiptarë, domethonë, çdo herë kem qenë në lëvizje nga sistemi i atëhershëm. Edhe ai e ka kry ni Shkollë të Lartë për Makineri në Zveçan, kur atëherë për me marrë ni notë sado, domethonë gjithë mësimdhanësit kanë qenë jo shqiptarë, serbë. Edhe atje osht' kualifiku në drejtimin e makinerisë se e ka deshtë me shpirt atë drejtim. Mandena osht' punësu në Stantërg, aty në maqineri, në pjesën, domethonë në pjesën e prodhimit. Aty ka punu derisa na largun prej punës me 8 gusht, 1990.

Ka qenë ni punëtor shumë i madh. I ka deshtë njerëzit që kanë punu. Na ka eduku gjashtë fëmi, na ka shkollu, na ka punësu, na ka martu edhe kjo ka qenë. Jom shumë falenderuese që ka qenë shumë i afërt, sidomos me gjininë femërore edhe kom kujtime t'mira edhe shumë fjalë të tina që edhe sot, sot i kam në mendje, sot i përmendi.

Anita Susuri: Çfarë gjenerate ka qenë baba ju?

Alije Gashi Tmava: Baba ka qenë në '36-tën ka qenë i lindur. Po ka qenë shumë shumë punëtor. Na ka eduku me punu drejtë, me deshtë njëri-tjetrin edhe sot e atë ditë jena shumë t'afërt në familje edhe pse kanë kalu shumë vite. Ashtu jem eduku nga ai edhe nga nana që me qenë, qoftë me familje, qoftë me shoqni, me rrethin ku jetojmë me qenë t'afërt. Jom shumë falënderuese.

Anita Susuri: Çfarë kujtime keni prej fëmijërisë kur keni, ju a jeni rritë në Mitrovicë?

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë atëherë?

Alije Gashi Tmava: Unë isha, thashë, vajza e tretë. Nana i kishte gjashtë fëmi, nuk ka qenë lehtë për m'i rritë, m'i eduku n'atë mënyrën sa ma t'mirë. Fillova klasën e parë edhe kur erdha n'shpi i thashë nanës, "Une këtë vjershë do ta thom si mësusja kur t'shkoj t'nesërmën du me dalë me recitu", kur une s'i kisha msu shkronjat, sa fillum shtatori. E thotë nana... "Pse une", thashë, "s'po di si msusja me lexu", tha, "Po s'din se ki me i msu shkronjat". Asaj i mora kohën, u deshtë m'i nda, me nda kohë me mu, m'i lanë gjanat tjera që e pritshin edhe ma mësoi vjerrshën. Une kur shkova n'klasë thashë, "Msuse une e kom msu vjerrshën", tha, "Hajde recitoje", e prej atëherë msusja në programet e shkollës që atëherë ishte, u festojke 29 nëntori, jo 28 nëntori...

Korab Krasniqi: Dita e Jugosllavisë

Alije Gashi Tmava: Po. Edhe çdo herë m'kanë marrë nëpër programe shkollore. E kështu vazhdova mandena edhe në shkollë t'mesme kryetare e shkollës, aktivitete rinore qishtu. Mandej na prej atij viti '80- '81 u regjistrova në Fakultetin Ekonomik, qishtu.

Anita Susuri: E n'atë kohë Mitrovica qysh ka qenë? Qysh ju kujtohet juve?

Alije Gashi Tmava: Une them, tash gjeneratat e reja m'vjen shumë keq që nuk e kanë jetën e mirë sikur ne që e kena pasë n'atë kohë. Une, domethonë, kom pasë kohë për mësim, kom pasë kohë me dalë me shokë e shoqe, atë pengesë nuk e kem pasë. Atëherë nuk ka pasë kafiqa si tash, u hapë... në Zveçan e kom kry tri vite shkollën e mesme se isha në atë, gjenerata e parë me mësim të orientuar edhe atje osht' hapë ni kafiq, njo u hapë në Mitrovicë te Xhamia Murati, Ura e Ibrit.

Po nuk kena shku shumë shpesh, kena shku n'raste të ditëlindjeve e kështu. Por, ka qenë ni kënaqësi. Apo kem dalë kem shëtitë në korzo. E kem ktu në Mitrovicë "Ballkanin" që osht' shumë i vjetër ni ambëltoe edhe, "Hajde se verës do t'pija bozë", e kem pasë vendin aty takime kështu me shokë e me shoqe. Kjo.

Anita Susuri: E jeta kulturore qysh ka qenë? A keni vizitu, për shembull, kinema, teatër e këto?

Alije Gashi Tmava: Po, po, po. I kena... jetën kulturore e kena pasë shumë t'mirë edhe Mitrovica njihet, njihet me kulturën, me muzikën, me artin. Them që, ndoshta gabo që them, osht' vendi i parë në Kosovë që i ka pasë, ktu kem pasë, këngëtar TNT ka qenë ni grup, ka qenë Haki Misini edhe shumë e shumë... Ndoshta s'po m'kujtohen për momentin, por jetën kulturore e kena pasë shumë t'mirë.

Une si studente në Prishtinë s'e kom pasë dëshirë me dalë me shëtitë, t'premtën kur jom ardhë në Mitrovicë atëherë m'u ka dokë që frymoj shumë ma mirë edhe pse, a din, njejtë po ashtu. Në Mitrovicë ka pasë jetë rinore shumë.

Anita Susuri: Për shembull, kinematë, sa shpesh keni shku ose teatër?

Alije Gashi Tmava: Kem shku se ishin disa filma që organizojshin falë artistëve tanë që murrën hapa. Fillun, "Lepuri me Pesë Këmbë", ka qenë e fundit që kom shku në teatër në Mitrovicë, e ata e kom shiqu me babin tim edhe ajo ka qenë e fundit. Ka pasë, ka pasë. Kem shku edhe me shkolla atëherë nëpër teatër që kanë qenë ato t'kufizume, kanë qenë me cenzurë për shembull. A ma vonë fillunë artistë tanë me marrë hapa edhe me bo xhirime të filmave me tematika shqiptare, kombëtare, ishte kënaqësi.

Anita Susuri: A ka pasë edhe filma prej Shqipnisë, për shembull që janë sjellë?

Alije Gashi Tmava: Jo, jo, jo, jo. Jo nuk ka pasë. Une sa e di jo.

Anita Susuri: Po m'intereson tash, Mitrovica osht' ni qytet industrial edhe shpesh herë gjatë intervistave tona kanë përmend kur osht' marrë rroga në Trepçe ka qenë nifarë tolloviqe, njerëzit t'cilët kanë ble janë furnizu. A ju kujtohet juve qysh ka qenë kjo?

Alije Gashi Tmava: Po m'kujtohet shumë mirë se kur janë marrë pagat në Trepçe ka lulëzu qyteti edhe dyqanet kanë qenë përplot. Që ndodhë aty ni motër e kishte ni dyqan të Dibrës, çilibara e Dibrës, ka qenë e furnizume me qilima t'leshta e çka po di une. U deshtë me majtë rend me policë, domethonë kur jonë marrë pagat. Kur i ka marrë Trepça pagat. Ka qenë kënaqësi shumë.

Anita Susuri: Ju thatë që shkollën e mesme e keni vazhdu në Prishtinë...

Alije Gashi Tmava: Në Zveçan.

Anita Susuri: Në Zveçan...

Alije Gashi Tmava: Tri vite në Zveçan.

Anita Susuri: Qysh ka qenë ai udhëtimi edhe qajo kohë për juve edhe qysh keni marrë vendim me u orientu në qat' shkollë?

Alije Gashi Tmava: Kena pasë autobusin lokal që udhëtojshim. Do herë kem shku n'kamë, do herë jem kthi n'kamë t'u këndu me shokë e me shoqe. N'atë kohë ishte edhe rregullimi rrugës tash që osht' rrugë kryesore prej stacionit deri atje, janë varre tana shqiptare m'u aty n'hymje të Zveçanit. Kem shku veç vendosshim me shku atëherë vazhdojshim shkojshim deri në shkollë. Kështu n'atë moshën rinore s'kishim lodhje as kurgjo.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj... nëse keni diçka për shkollën e mesme me vazhdu ose qysh pastaj keni vazhdu shkollimin? Qysh ka qenë për juve qajo periudhë?

Alije Gashi-Tmava: Po fundi i vitit të katërt, fillunë ato pasojat ato diferencimet e filloi gjendja m'u keqësu në tërë Kosovën kështu edhe çdo hap u deshke me qenë shumë t'kujdesshëm. Mandej, aty filloi, '89, '79-ta, '80 veç fillunë gjanat me ndryshu.

Anita Susuri: A keni dëgju për këto, për shembull, kanë qenë disa grupe ilegale, a ju kanë ardhë n'vesh qato?

Alije Gashi Tmava: Po, si jo. Une ju bashkangjita masnena si brucoshe e viteve 1981, aty mandena me 11 mars në menzë domethonë, filloi, me thonë, hapi i parë prej studentëve u rrotullunë karrika, tavolina si preteks mosndryshimit të kushtetutes ku n'ato vitet e... '81-shin veç u panë ku ishte qëllimi i regjimit të atëhershëm, i komunistëve të atëhershëm ndaj popullatës shqiptare. Se me t'vërtetë e patëm atë hovin e shkollimit, shumë kuadra shqiptartë dulën me profesione të ndryshme kur atij regjimit i pengojshin edhe kuadrat shqiptare.

Anita Susuri: N'vitin '81 thatë që keni qenë brucoshe...

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: Keni vazhdu fakultetin në Prishtinë...

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: Po tash po du m'u ndërlihdë, mos t'i ikim ksaj teme në demonstrata që kanë ndodhë se ishim t'u folë për demonstrata. A ju kujtohet juve 11 marsi? Ku keni qenë ju edhe çka keni bo ju në ato momente? Çka keni pa?

Alije Gashi Tmava: Ajo ka qenë e tëra që filloi ni hap se me 26 mars e pritshim stafetën e Titos atëherë se u përcjellke çdo vit. Atëherë gjithçka u bo bojkot, nuk... studentat, ne nuk e bojkotum, nuk dulëm me pritë edhe gjithçkafi e murrë atë kahjen nacionaliste, shqiptartë nacionalista, studentat. Edhe kurgjo ma s'ish, s'kishe siguri në kurgjo. Fillunë mandej diferencimet, fillunë mandej studentat m'u burgosë, qishtu.

Anita Susuri: E me 11 mars që e përmendet menzën, a keni qenë ju aty në menzë?

Alije Gashi Tmava: Jo, për momentin nuk kom qenë. Nuk kom qenë.

Korab Krasniqi: Qysh ka qenë atmosfera, a t'kujtohet? Prej intervistave të ndryshme kemi dëgju që ka fillu qetë, domethonë prej menzës janë rrotullu tavolinat pastaj kanë fillu me marshu e kështu me radhë. Qysh u konë atmosfera në mesin e studentëve? Çka keni diskutu n'atë kohë? Qysh e keni përjetu komplet?

Alije Gashi Tmava: N'atë kohë, domethonë, bisedimet e këto kanë qenë, "Stop dhunës ndaj shqiptarëve", "Stop dhunës ndaj studentëve, nxënësve", se kishim presion nga shërbimet sekrete, ishim të përcjellun. Unë kom pasë rast edhe n'lagje aty kem pasë njerëz që, domethonë na kanë përcjellë, kështu.

Anita Susuri: E ju kanë përcjellë, domethonë kështu para demonstratave apo pasi ka ndodhë?

Alije Gashi Tmava: Pas demonstratave.

Anita Susuri: E gjatë demonstratave thatë për shtafetën e Titos, a keni dalë? Po mendoj, fillimisht nuk keni dalë me pritë po pastaj ka ndodhë ni tollovi aty edhe ka eskalu gjendja. A keni qenë edhe ju pastaj jashtë rrugve dikum a keni pa çka ka ndodhë?

Alije Gashi Tmava: Po s'e e kem pasë atë kureshtjen me vëzhgu çka po ndodhë se si, kush osht' pjesë e asaj pritjes apo kupton? Kur ne e bojkotumë. Kështu.

Anita Susuri: Përmendët Prishtinën edhe jetën ndërmjet Mitrovicës edhe Prishtinës, thatë që në Mitrovicë ka pasë ni gjallni ma ndryshe...

Alije Gashi Tmava: Shumë.

Anita Susuri: Po qysh ka qenë Prishtina n'atë kohë për juve?

Alije Gashi Tmava: Për mu ka qenë Prishina me shku n'fakultet, me i dëgju ligjeratat, me hy në provime edhe si m'u kthy ma shpejt në Mitrovicë. Qikjo ka qenë.

Anita Susuri: Çka kanë qenë dallimet, për shembull ndërmjet Prishtinës edhe Mitrovicës?

Alije Gashi Tmava: S'di çka t'them, në Prishtinë, edhe sot tërë Kosova është në Prishtinë, a po kupton? Aty në Prishtinë kena pasë kultura të ndryshme prej krejt trevave të Kosovës e jashtë Kosovës, po mbi t'gjitha vendlindja osht' vendlindje. Une jom lokaliste shumë (qeshë). E du Mitrovicën shumë.

Anita Susuri: E përmendet edhe ni vend ku keni dalë, "Arabeska" që ka qenë.

Alije Gashi Tmava: Po, po.

Anita Susuri: Tregim për qaty...

Alije Gashi Tmava: Po, po, po. Edhe ma kurrë s'kem shku, apsolut s'kem shku se kem dalë në korzo e kem bo ni xhiro ndoshta. Na si studenta nëse une s'kom pasë para, tjetra ka pasë edhe kështu që e kem bo ni xhiro, je kthy, ke msu. Qashtu e ke bo ni shëtitje, jem fresku.

Anita Susuri: Nëse mundeni me tregu edhe niherë për qat' ngjarjen që ju ka ndodhë? Se na tregutë ma herët po nuk u regjistru.

Alije Gashi Tmava: Po. E kisha dhanë ni provim, Isak Mustafa ka qenë ni profesor, shumë i ashpër i thojshin. Meqenëse une e dhashë provimin me t'parën edhe nuk pata telashe edhe dulëm me ato koleget me pi kafe me i qarrosë. Edhe kur u ulëm na t'u bisedu i shishim, e shihim ni njeri t'u na vëzhgu edhe e patëm ni frikë ndaj tina se non stop t'u na vëzhgu ne. Ishim krejt femra. Mandej i lam ato n'gjystë, dulëm shkum edhe ma kurrë s'kem shku. Apsolut.

Anita Susuri: I keni pasë do, si thatë, do...

Alije Gashi Tmava: Jo, na s'i kem pasë po ai personi që ishte aty afër ai vëzhgojke po me ato simbolet tona shqiptare ishte, po e pam që s'ish njeri, s'ish shqiptar i vërtetë. Se atëherë ka pasë njerëz si shqiptarë që kanë punu në shërbime sekrete të ish Jugosllavisë, ashtu.

Anita Susuri: A ju kujtohet edhe qysh ka qenë? Thatë diferencimet e përndjekur kanë qenë grupet me t'ri? Qysh ka qenë tjetër ni ngjarje, për shembull, që iu ka ndodhë pas demonstratave? Ka pasë edhe orë policore po m'duket.

Alije Gashi Tmava: Po, po, ka pasë. Ato kanë qenë po u deshtë me iu, me iu, me ikë atyne gjanave për mos me pasë telashe me u përpjekë me ta.

Anita Susuri: Thatë që n'vitin '85 jeni punësu në Trepçe...

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: E keni përfundu në çfarë viti?

Alije Gashi Tmava: Me 10 janar '85. '81 kom qenë brucoshe në '85-ten jom punësu.

Anita Susuri: Po. Qysh ka ndodhë kjo krejt? Punësimi? Po m'duket keni qenë bursiste...

Alije Gashi Tmava: Nuk kam qenë bursiste. Babën e kom pasë aty t'u punu, ka qenë ni konkurs edhe jena punësu disa t'ri. Në mesin e tyne ka pasë shqiptarë edhe serbë edhe mandej kështu.

Anita Susuri: Ju ekonominë e keni përfundu?

Alije Gashi Tmava: Po, ekonomiste.

Anita Susuri: Edhe keni fillu si ekonomiste...

Alije Gashi Tmava: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë krejt puna juj?

Alije Gashi Tmava: Atëhere ka pasë shumë pak femra shqiptare, thashë, nuk ka pasë shumë femra shqiptare por çdo gja ishte në gjuhën serbo-kroate. Shumë shkrime unë kisha t'boj me fuqi punëtore, tash me thonë, burime njerëzore. I kisha llogaritjen e invaliditetit të punëtorëve që ishin në minierë, ata që kishin lëndime edhe kur i merrsha kartelat e minatorëve çdo gja ishte çirilicë.

Ne e kem pasë fatin, qoftë t'mirë ose t'keq, gjuhën serbo-kroate e ke msu prej shkollave fillore edhe anglishten. Edhe p'i thom une, një ka qenë, ai Momiri i lindun i rritun në Drenicë atje, po e dike shqipen sikurse une. Edhe p'i thom, thashë, "Une s'pe kuptoj". Meqenëse une e kuptojsha gjuhën, thashë, "Po une do t'i shkruj kto qysh e keni shkru çirilicë, une po e shkruj shqip [latinisht]". Tash aty përfundi saj e shkrujsha shqip. Për shembull, qe *rudar palioc* që është xehtar ndezës që ishte në minierë. Edhe kështu fillove me ato tamon kështu me punu, se na prej bankave studentore e kishim nifarë sigurie, frikën s'e kishim hiç.

E atij, s'më tha kurgjo, s'i pëlqeu shumë po vazhdova qashtu punojsha. Mandena fillunë, filloi, në '81-tën, '85-tën, '83-tën Rankoviqi e di që vdiq edhe fillunë tashti protestat, mitingjet e shkive, Millosheviqi nëpër tubime në Fushë Kosovë, ku ta di une naltë, poshtë. Edhe fillunë me prekë kushtetutën e '74-tës, m'i cënu t'drejtat e shqiptarëve se i pengojke arsimimi i shqiptarëve tash shumë intelektualë, mjekë, inxhinierë, ekonomista, jurista dulën shqiptarë. Edhe minatortë t'u i pa këto sjellje të tyne edhe jo, domethonë minatortë, minatortë kanë qenë shumë t'fortë, kanë pasë dije.

Ata vendosën me u mbyllë në minierë m'i tregu që nuk bon m'i cënu, nuk bon me na cënu kushtetutën. Mandena arsimin, puntortë e arsimit m'i penzionu parakohshëm, se aty ishte arma kryesore e shqiptarëve. Edhe minatortë ni ditë prej ditësh vendosën m'u mbyllë në zgafellë. T'them që kjo nuk osht' hera e parë që shqiptartë jonë mbyllë në zgafellë se edhe në 1939-ten ishin pasë mshelë shqiptarë në zgafellë. Edhe grevë që ka zgjatë ni javë, ka qenë kjo greva e, 20 deri me 28 shkurt '89.

Anita Susuri: A ju kujtohet, se po ju kthej pak, për qit' temën e vitit '39 se na ka tregu edhe zonja Bahtije Abrashi...

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: E Aziz Abrashit, gruaja...

Alije Gashi Tmava: Po.

Anita Susuri: Që baba i saj ka qenë aty, po a ju kujtohet juve, sigurisht edhe baba juj ka qenë i përfshirë?

Alije Gashi Tmava: Jo, nuk ka qenë 1939-tën nuk ka qenë se baba ka lindë '36-tën...

Anita Susuri: A po.

Alije Gashi Tmava: Po ajo grevë 90 përqind kanë qenë shqiptarë, 90 përqind kanë qenë n'atë grevë shqiptarë se dihet edhe prejardhja e Trepçës prej Sasve, mandej okupimi i angleztë që e kanë marrë, sot osht' kolonia angleze [miniera] me plantacion që e kanë ndërtu angleztë mandena sundimi, si tona herë kjo, sistemi socialist i Serbisë bashkë me kto serbo-kroat-slllovene, kto dy shtetet Slloveni e Kroaci e uzurpojnë prapë prej anglezëve, jo gjermantë, jo kështu. Por, '39-tën ka qenë ni grevë ku 95 përqind kishin qenë shqiptarë.

Anita Susuri: Kjo grevë sigurisht ka qenë për kushtet e punës apo politike?

Alije Gashi Tmava: Kjo e '39-tës a?

Anita Susuri: Po, për kushte po nuk them politike n'atë anë. Atëherë se kanë qenë super fuqitë e ka qenë Anglia ka qenë gjermani kështuqë pak shqiptarë ka pasë aty të ngritur.

Korab Krasniqi: Në '85-tën faktikisht jeni konë edhe e re veç sa i keni kry studimet, keni hy me ni punë në Trepçë në financa, keni pasë edhe koleg tjerë serb apo jo?

Alije Gashi Tmava: Po, po.

Korab Krasniqi: Qysh kanë qenë raportet? Qysh kanë qenë dinamikat? Se ju vetë e thatë që '80-ën, '81-tën veç fillon me u tensionu pak situata ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve për shkak idesë së largimit t'drejtave kushtetuese. Qysh jeni, domethonë, qysh kanë qenë dinamikat? Raportet? Marrëdhëniet kolegiale me shqiptarë edhe me serbë? Qysh keni shku, për shembull me pi kafe ose me hangër drekë? Ose qysh ka qenë qajo atmosferë?

Anita Susuri: Qysh ka funksionu marrëdhënia juj?

Alije Gashi Tmava: Prej ktyne rasteve që ndodhën, mo kanë qenë krejt të zbehta, nuk i ke folë as s'të ka folë. Edhe atëherë kanë qenë edhe atëherë kanë qenë biseda të ftofta, nuk kanë qenë biseda ku ta di une. Une e kom pasë ni shoqe punojke edhe kur u dëgjojshim në telefon ajo kishte n'zyre, ishte n'zyre t'përzimë thuajse baraz, tre me tre. E unë nuk e kisha asnjë n'zyre mandej ishin ato masat e dhunshme, fillunë m'i pru prej, që vishin kur ishte lufta në Kroaci, fillun m'i pru njerztë m'i punësu kështu e atëherë gjithçka ndryshoi, a po din. Ato bisedat e ftoha, vetëm zyrtare se kështu nuk ke pasë, nuk ke pasë biseda t'mira.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Thatë për punën e juq që jeni marrë edhe me llogaritjen e dameve që u bo, për shembull dëmtimet që i kanë pasë nëpër trup e prej aksidenteve minatorë. Çfarë aksidente, për shembull ka pasë edhe sa shpesh kanë ndodhë këto?

Alije Gashi Tmava: Ato aksidentet kanë qenë se kushtet kanë qenë t'vështira, makineria e vjetërsume edhe mos kujdesi n'punë osht' ardhë deri te dëmtimi trupor, qoftë lëndim trupor, n'kamë, n'dorë. Kem pasë edhe vdekje, [aksidente] me fatalitet kur, për shembull janë punësu bijtë ose bijat e minatorëve ka ndodhë qisi raste.

Anita Susuri: Domethonë njerëz që nuk e kanë njoftë mirë punën apo?

Alije Gashi Tmava: Po jo, ndodhin ato gjana se aty n'minierë thuhet, "Me fat!" Kështu që, aty nuk ka siguri, se mvaret tashti n'minierë une kom hy ni javë ditë kom qenë aty, po mvaret te minimet e qysh puntortë i punojnë e i përgatisin vendet. Po ndodhin edhe ato shpërthimet që nuk e presin.

Korab Krasniqi: A na shpjegoni procesin e vlerësimit, qysh e vlerëson, për shembull, ni aksident për kompenzim invalidor për shembull? Qysh u dukë ai proces?

Alije Gashi Tmava: Atëherë ka qenë proçesi po tash, tash mas luftës nuk kena, nuk e kem këta. Osht' mjerim që nuk osht', se kem t'lëndumë edhe tash, osht' mjerim që ky ligj nuk osht' aprovu në kuvend, shumë osht' mjerim. Atëherë osht' përcjellë se, osht' përcjellë, osht' përcjellë vendi i punës i atij punëtori, osht' marrë ni mesatare e pagës mandena iu ka bo kompenzimi i damit sa osht' lëndu, çfarë dami, sa përqind të damit. Atëherë ka qenë, mund t'them, se ai sistem, ato t'mirat duhet m'i marrë edhe tash edhe pse jem sistem demokratik, po te çështja e punëtorëve duhet me pasë shumë kujdes, ata janë të shkelun, nuk e kanë këta. Nuk e kanë.

Korab Krasniqi: E qysh vlerësohen damet, për shembull lëndimet nëse po supozojmë...

Alije Gashi Tmava: Lëndimin ia jep mjeku, komisioni mjekësor e cakton damin, mandena bohet në bazë të dokumentacionit, në bazë të mjekut që e cakton a tash, tash nuk kem.

Anita Susuri: Thatë për grevën, po paraprakisht ka ndodhë marshi dhe ka fillu...

Alije Gashi Tmava: Marshi, 17 nëntori.

Anita Susuri: Qat' kryengritjen nëse muj m'i thonë. Qysh ka qenë situata në Trepçë qato ditë? A osht' ditë që po organizohet diçka?

Alije Gashi Tmava: Thashë, minatortë nuk kanë qenë t'pavetëdishëm as nuk... e rastësishme nuk ka qenë ajo, se kur Millosheviqi dilte nëpër mitingje nëpër Fushë Kosova edhe haptazi u shprehke që do ta cënon kushtetutën e '74-shit, të drejtat e shqiptarëve. Atëherë një për t'gjithë, t'gjithë për një. Edhe minatortë e kanë diskutu këtë çështje, janë mbledhë edhe e kanë fillu marshin për Prishtinë. Sikurse ata që i bojshin marshet nëpër Kosovë. M'i tregu që stop ktyne, kësaj dhunës.

Anita Susuri: A ju kujtohet juve qajo ditë?

Alije Gashi Tmava: Shumë mirë u konë 17 nëntori, shi ka qenë. Mandej, tërë Kosova u solidarizua me minatortë prej t'gjitha vendeve të Kosovës e jashtë Kosovës fillunë njerëzit diku s'di sa mijë kanë qenë veç ktu në qendër, atëherë i thojshin Boro Ramiz. Mandej fillunë qishtu krejt Kosova me ardhë në Prishtinë, m'i stopu këto, m'i kerku ktyne liderëve tanë që kanë qenë atëherë në udhëheqësi m'i pengu këto gjana.

Minatortë kur u mbyllën në zgafellë, unë isha në zyre. Atëherë vazhdova edhe unë u sulidarizova me minatortë. Edhe t'u i pa, kaloi ni ditë, kaloi e dyta ditë, minatortë nuk deshtën me dalë. I kerkojshin udhëheqësitë, udhëheqsinë në atë kohë në Krahinën e Kosovës. Atëherë puntortë që ishin jashtë miniere, jashtë zgafelle fillunë sallën e prodhimit me shndërru në ni spital improvizues. Filloi gjendja e minatorëve t'ju keqësohet. Protestojshin me pi, me hangër derisa të realizohen kërkesat që ata i kishin parashtru.

Atëherë filloi numri t'rritet, fillon gjendja e minatorëve të keqësohet edhe u hapë me thanë spitali i improvizum. Aty kem pasë ni rol, kem luftë rolin e motrave medicinale. I kishim mjekët tanë që kanë qenë mjekët e punës. Motrat u angazhunë, po kish nevojë me u angazhu numër ma i madh. Aty prej 20 shkurtit gjerë me 28 shkurt kur jonë dalë kom qenë aty natë e ditë që s'kom shku kurrë niherë n'shpi. Derisa atë ditë kur kanë dalë, unë kom shku m'u pastru edhe ata dulën.

Masi që kanë dalë kanë mbetë minatortë me gjendje t'randë shëndetësore aty edhe disa prej tyne i kanë transferu në spitalin e Mitrovicës. Mandena kanë hy me dhunë i kanë keqtrajtu edhe qashtu pse kanë qenë t'lëndumë i kanë keqtrajtu organet e sigurisë serbe n'atë kohë, mandena gjithçka përfundoi. Fillunë masat e dhunshme, fillunë me na marrë n'pytje. Gjithçka ishte e errët masi minatorët dulën nga zgafella.

Korab Krasniqi: Qysh vendosët ju me shku me ndihmu motrat medicinale? A ju thirri dikush apo vet vendosët me shku me ndihmu?

Alije Gashi Tmava: Ne u solidarizum me minatorë, me popullin tonë.

Anita Susuri: Po fillimisht qysh e morët lajmin që jonë mbyllë në zgafellë?

Alije Gashi Tmava: Po, ne nuk ka qenë problem. Kjo kolegia në centrallë që janë bo lidhjet, “U mbyllën minatortë, s’do t’dalin derisa të realizohen kërkesat”, edhe po na e kem vendin aty. Unë e thashë prej ‘81-shit mo atë problem s’e kom pasë edhe iu bashkangjitëm minatorëve.

Anita Susuri: A keni shku poshtë?

Alije Gashi Tmava: Po, e përshëndes Ramiz Preshevën, Kadriu përndryshe. Ai ka qenë inxhinier edhe ka qenë si udhëheqës se kush mundet me shku m’i vizitu minatortë në të pestin edhe të tetin horizont. Kështu që, i kena përcjellë grupet e njerëzve që kanë ardhë prej Kosove edhe jashtë Kosove, m’i vizitu që dëshirojshin gazetarë e kushdo. Po qysh tha edhe Ganiu, gjithçka ka qenë në vëzhgim, në përcjellje prej portës atje kush vjen, kush s’vjen. Edhe jem shku iu kem bashkangjitë grupit vizitues që kanë ardhë.

Anita Susuri: Domethonë, secili grup vizitues që ka qenë keni shku edhe ju me ta?

Alije Gashi Tmava: Po, po.

Anita Susuri: Kush, a ju kujtohet kush ka ardhë? Me kond keni shku ju poshtë?

Alije Gashi Tmava: Kanë ardhë delegacione anekand Kosove, anekand, kanë ardhë prej Sllovenie, Kroacie, kur nga shteti slloven kem pasë t’mira, kem pasë shtretër m’i furnizu spitalin, jastek, jorgana t’gjithë i kanë pru në Stantërg. Kem pasë ndërtesë aty që i kena vendosë edhe, po ndoshta shumë pak na ra m’i përdorë mandej i murrën, spitali i murrën, organet e sigurisë i dërgun në spitalin e Mitrovicës.

Anita Susuri: A ju kujtohet minatortë n’çfarë gjendje kanë qenë?

Alije Gashi Tmava: Kanë qenë shumë t’vështirë. E kom ni rast që e kom n’kokë ni Xhylazim Sumiçi i Reshanit, fshati Reshan, ai ishte n’gjendje t’randë. Ndonjëherë na bojke ni shaka se nuk e dishim si osht’ koha. Ajo koha e pranverës nuk ka qenë si tash ftohtë, ka qenë pak ma e nxehtë edhe qashtu natë e ditë, shtatë ditë aty kom qëndru bashkë me shoqe, nuk kom qenë e vetmja.

Anita Susuri: E ju që thatë si motër medicinale, a keni qenë në spitalin e improvizumë apo edhe poshtë?

Alije Gashi Tmava: Jo, në spitalin e improvizumë aty. Ndhimë kanë qenë ekipa mjekësore me motra që kanë qenë me mjekë, por ne e lujsim atë rol me iu dalë ndihmë, “Jo iu keqësu gjendja. Thirre tash mjekun”. A po kupton? Qishtu.

Anita Susuri: E që thatë me delegacionet keni qenë, çka kanë bisedu ata? A ju kujtohet ndonjë bisedë e tyre?

Alije Gashi Tmava: Ka qenë edhe shumë zhurmë. Puntortë i kërkojshin këta udhëheqësit tanë që kanë qenë n'atë kohë me dhanë dorëheqje, "Përderisa nuk na përkrahni në aspektin kombëtar", domethonë, kjo grevë e minatorëve ka qenë çështje kombëtare, nuk ka qenë e rastësishme. I lypshin edhe domethonë, Stipe Shuvarin⁴. Mos t'i ceki me emra këta krejt, deri në realizimin e kërkesave.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe jashtë minierës familjartë, për shembull, a i keni taku? A kanë ardhë aty?

Alije Gashi Tmava: Jo, na. Kanë qenë njerëz tjerë që janë taku, se kanë ardhë aty te rrethoja kanë thonë, "Qe prej nesh i ki dy lopë për me bo ushqim", apo, "E ki qet' arë, e ki nga kjo familje". Kanë ardhë prej anekand Kosovës, "Une po du me i dalë Zot për me hangër për me pi", se çashtja alarmante ishte se nuk ka me honger me pi edhe ata protestojshin. Kështu që, ka pasë njerëz shumë shpirtë bardhë e zemërapur që thojnë, që jonë solidarizu me këtë grevën e minatorëve.

Anita Susuri: Spitalin e improvizum qysh e di une e kanë hjekë shumë shpejt forcat policore. A ju kujtohet ndoshta?

Alije Gashi Tmava: Po, une thashë kam shku n'shpi m'u pastru e n'atë moment nuk kom qenë se i thashë nanës i thashë, "Qysh bre dulën ata?" Se mo ni javë ditë hiç pa shku n'shpi, paramendo. Po ka qenë tmerr, ka qenë, gjithçka ka qenë. Mandej kur ke shku n'punë gjithçka ka qenë e zymtë. Une kur u ktheva në drejtori, aty në zyre tha ni person. Tha, "Ti s'ke qenë, zero-zero i ki meditet". Thashë, "S'ka problem", thashë, "kur ia hiqsh kësaj serbës që ka shku në Gazimestan⁵ *Bitka na Kosovu*⁶ [Beteja e Kosovës]", thashë, "m'i hekë edhe mu, s'e kom atë problem". Mandena m'qitën n'listë të parën n'largim prej pune, qishtu.

Korab Krasniqi: A t'kujtohet, masi që e përmendët Gazimestanin, a t'kujtohet disa muj ma vonë masi që ka ndodhë greva, Milosheviqi në 600 vjetorin e Betejës së Kosovës vjen e mban fjalim. A t'kujtohet qajo qysh ka qenë?

Alije Gashi Tmava: Po qajo ka qenë edhe që fillunë këto marshi '88-ën ka qenë '88. Mandej që filloi marshi me 17 nëntor, mandej fillunë këto grevat e minatorëve. Po, ata çdo here e festojnë këta në Gazimestan edhe fillunë diferencimet, fillunë me na marrë në pyetje. Kaloi edhe disa muj...

⁴ Serbo-Kraotisht: Stipe Šuvar (1936-2004) ishte sociolog dhe politikan kroat. Gjatë Grevës së Minatorëve 1989, ai ishte kryetar i Komitetit Qendror të Jugosllavisë.

⁵ Gazimestani është emri i memorialit dhe monumentit që përkujton Betejën e Kosovës (1389). Çdo vit, në Vidovdan (Ditën e Shën Vitit), më 28 qershor, mbahet një përkujtim pranë monumentit.

⁶ Beteja e Kosovës u zhvillua më 15 qershor 1389 midis ushtrisë së udhëhequr nga princi serb Lazar Hrebeljanović dhe ushtrisë së Perandorisë Osmane nën komandën e Sulltan Murad Hüdavendigâr.

Anita Susuri: Për shembull, kur iu kanë marrë në pyetje çfarë pyetje kanë qenë? A ju kujtohet? A ju kanë marrë në sekretariat apo n'zyre t'juja?

Alije Gashi Tmava: Jo, mu nuk më morën n'pyetje, mu m'qitën n'largim prej pune. Koleget e mia i kanë marrë n'pyetje, "Pse ke shku? Kush t'ka thonë?" Sikur ata që kanë ditë me t'bo pyetje, e qito gjana janë.

Anita Susuri: Në cilin vit iu kanë largu prej punës? '90-ën apo?

Alije Gashi Tmava: '90-ën, me 8 gusht 1990, osht' mbyllë dera për minatorë. Domethonë, prej 20-28 shkurt që i morën, që ke greva, mandena i morën në burg këta lidertë prej Aziz Abrashit e Burhan Kavajës e Ibush Jonuzit, e në krye këtë Azem Vllasin e burgosën. Mandena, ata i mbajtën ni vit në prill '90-ës i kanë lshu edhe gjithçka... edhe disa minatorë janë burgosë, ni numër i madh i minatorëve janë burgosë. Disa e lshunë, fillun qatëhere me dalë jashtë Kosove.

Anita Susuri: Paraprakisht mas grevës, domethonë, meniherë disa ditë me 1 mars ose diçka kështu ka qenë kur i kanë marrë Burhanin, Azizin, e çka osht' bisedu? Qysh u përjetu kjo te puntortë e tjerë? Administrata, për shembull, te rrethi juj që keni punu?

Alije Gashi Tmava: Ajo u përjetu shumë keq, se ma kur liderin e merr mandena puntortë heshtin. S'ke pasë çka t'boj.

Anita Susuri: Çka keni mendu që ka me u bo ma tutje?

Alije Gashi Tmava: Ne e kem mendu që ata lirohen, po padrejtësisht u mbajtën në mënyrë politike. I jepën kahje si seperatista, irredentista, qysh na kanë jep gjithëherë kahje.

Anita Susuri: Ka ndodhë edhe ni grevë e dytë po m'doket ma vonë disa muj...

Alije Gashi Tmava: Po, minatortë qishtu u mbyllshin për lirim e ktyne prej burgu.

Anita Susuri: A e keni përjetu edhe ato po?

Alije Gashi Tmava: Po, po, na mandena kem qenë, domethonë në zyre. S'kem shku poshtë se vetëm minatortë disa ndrrime, ndrimi parë, ndrimi dytë, ndrimi tretë. Për shembull, e bojkotojshin 300-400 vetë qishti që në shej proteste me iu tregu ktyne.

Anita Susuri: Domethonë, mo puna nuk ka vazhdu normalisht?

Alije Gashi Tmava: Jo, jo, jo. S'ka pasë efikasitet, s'ka pasë prodhim t'mirëfilltë mo.

Korab Krasniqi: Meqenëse jeni konë n'financa ndoshta vetëm keni mujtë me pa qito dinamikat e pagesave të stafit. A keni mujtë me vrejtë qysh ka ndiku qikjo greva në aspektin e prodhimtarisë? Në aspektin e përgjithshëm t'profitit të Trepçës?

Alije Gashi Tmava: Po ajo dihet që osht' ra dukshëm, osht' ra, ma s'ka pasë interesim t'prodhimit absolut. Se edhe n'shejë proteste që u burgosën liderët e kombinatit edhe çdo herë ka qenë ma e zbehtë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë, për shembull reagimi i Jugosllavisë, po them, kryesive? Sepse e dijmë që Trepça ka qenë ni rang shumë t'naltë sa i përket industrive që kanë qenë kryesore në Jugosllavi. A ka pasë vizita? Telefonata? Brengosje në lidhje me prodhimin?

Alije Gashi Tmava: Po normal që ka pasë brengosje, se Trepça që po thu ka qenë e para në Evropë, e treta në botë për prodhimtarinë e plumbit, të zinkut. Njifet në tërë botën kur lakmi ia kanë pasë shumë shtete ose se si me qenë aksionarë në Trepçë. Po gjithçka e murrë kështu fundin, qysh me thanë, derisa erdh në ato vitet e '90-a që na largunë. Ato parullat që kanë qenë nëpër kto marshin kanë qenë, "Trepça punon, Beogradi ndërton", "Poshtë sërbo-mëdhenjëve" mandena edhe shumë e shumë parulla tjera.

Anita Susuri: Qajo ditë që thatë iu kanë largu prej punës, a ju kujtohet qysh ka rrjedhë kjo krejt?

Alije Gashi Tmava: Une për fat, me thonë, për fat të mirë a të keq s'e di, por unë atëherë e mora pushimin e lehonisë edhe ato s'pat as tri ditë... dhe nuk kom qenë atë ditë, se atë ditë kur kom shku, se babi m'ka punu edhe bashkëshorti masnena kanë qenë dyrtë e mbyllme për shqiptarë, për shqiptarë s'ka vend. Qikjo ka qenë

Anita Susuri: E po thuni që edhe baba juj ka punu edhe bashkëshorti ka punu, ka qenë si ni lloj e traditës e Mitrovicës edhe rrethinës me punu në Trepçë...

Alije Gashi Tmava: Po, 90 përqind e mitrovicalive, domethonë kanë punu në Kombinatin Trepça. Kuptohet pjesa e Zveçanit me Mitrovicë edhe Kishnica, edhe ajo osht' pjesë e... domethonë, nën ombrellën e Trepçës. Po, 90 përqind.

Anita Susuri: A jeni njoftu edhe ju me bashkëshortin e juj mrena Trepçës apo si?

Alije Gashi Tmava: Po, po, mrena Trepçës edhe ai ka qenë osht' inxhinier i gjeologjisë edhe ai osht' ni kuadër prej shqiptarëve t'parë, para Vjollcës është punësu. Edhe paraprakisht ka qenë asistent në fakultet këtu masi osht' diplomu. Edhe, aty, domethonë në grevë kena qenë bashkë. Edhe ai ka qenë përkrahës, bashkë kem qenë.

Anita Susuri: Ndërsa, në vitin '90-të te dytë jeni largu prej punës.

Alije Gashi Tmava: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj jeta për juve? Qysh jeni gjetë?

Alije Gashi Tmava: Pleqtë kanë thonë, “Zoti po i çojke për ushqim, kurrë s’po metke kërkush keq”. Po u deshtë me i ndrru profesionet, u deshtë me u marrë me qysh me thonë, me transport, u deshtë me mendu për jetën se qysh do të vazhdojë ma tutje. Ni autobus e pat ble shoku me axhën e vet edhe [janë marrë me] transport vitet e ‘90-a. Fillunë me lshu Kosovën njerzhtë se mbijetesa ishte n’pytje edhe kështu që vazhdum jetën.

Punojke edhe në fakultet, po atëherë arsimi nuk osht’ pagu me vite e vite, e dini edhe ju vet. Edhe shumë familje e ndihmun familjen masi që na qitën prej punës. Ana e Dukagjinit e kanë ndihmu shumë Shalën, “Familja Ndihmon Familjen”, u formu edhe ni fond i solidaritetit. Mandej edhe kjo Shoqata “Nënë Tereza” edhe kjo vetëm brenda Kosovës. Edhe jashtë Kosove ka pasë që e kanë ndihmu familjet e Shalës, familjet e minatorëve.

Anita Susuri: E në vitet ‘90-a, ju domethonë veç bashkëshorti ju j osht’ marrë me punë private, ju keni qenë n’shpi?

Alije Gashi Tmava: Unë e kom rritë djaln, e kom rritë Korabin me lezet kështu pa e çu nëpër qerdhe (qeshë).

Anita Susuri: Qysh ka qenë n’përgjithësi situata? Keni jetu në veri apo në jug?

Alije Gashi Tmava: Jo, në jug kena jetu. Mandej, ato vitet e ‘90-a, vazhdimësi e kësaj janë ato vitet e ‘90-ta që fillunë financimi dhe blerja e armëve nga jashtë, filloi edhe kjo llegalja e UÇK-së. Kështu që, gjithçkafi pritshim se çka u bo, çka ndodhi. Edhe aty, edhe bashkëshortin e kisha n’atë grupin. Qishtu une e rritsha Korabin n’shpi edhe e këndojsha kaniherë atë kangën kur si studente e këndojsha, “Rritu, rritu biro si Korabi, e trim si Enveri të më bëhesh”. Por, prapë se prapë na e kem pasë atë dashni ndaj shtetit amë edhe nuk jam pishmon se qishtu.

Korab Krasniqi: Me kthy ndoshta se veç për pjesën për Trepçë përgjithësi pjesa e Mitrovicës ka qenë e ndikume prej luftës, ‘90-at e përmendët vet që jeni konë jashtë punës. “Familja Ndihmon Familjen” ka qenë një prej mënyrave qysh jeni mbështetë, familjet e minatorëve, pastaj jo puntë private e kështu me radhë. Domethonë, ka qenë ni periudhë mjaft e errët kështu. Po...

Alije Gashi Tmava: Shumë e errtë.

Korab Krasniqi: ‘97-ën, ‘98-ën, ‘99-ën qysh ka qenë për juve, për familjen e juv në përgjithësi? Qysh e keni përjetu luftën e fundit në Kosovë?

Alije Gashi Tmava: Domethonë, luftën e kem pritë, diçka do të ndodhë kur fillunë edhe shtetet e huja me na pranë atë, qysh me thonë, ato vujtjet që kem pasë ndaj regjimit serb. Atëherë, thashë ato vite u mobilizun ajo lëvizja popullore që ishte vrasja në, atje, që osht’ ba në Likoshan mandena gjithçkafi e pat’ atë hapin, çdo ditë pritshim gjëra t’reja. Edhe ishte kohë e durimit, kur baba në ato vite e emroi nipin me emrin Durim. Tha, “Se osht’ kohë e durimit, por do t’vjen koha do t’festojna”. Edhe ‘93-shin, mandena, ‘94-shin, mandena ‘96-tën tha, “Po vijnë ditë me festu”, ia qiti djalit tjetër emrin Urim. Kështu që, lufta e UÇK-së, domethonë dikush ka qenë ma i informum dikush ma pak i informum.

Unë dilsha në protestë, dy djem i kam: një Korab, një Granit. Nana m’kritikojke, më thojke, “Hajt se vet ke dalë, po pse po i merr fmitë?” Thojshin, “Jo, osht’ tradhëti! S’ka UÇK, janë tradhëtarë”. Këto janë konë ato parollat që u dëgjojin në mesin e popullit tanë. Mandena e murrë hovin UÇK-ja, dulë në skenë me 28 nëntor, msusin në Llaushë që e vrajtën, dulë me Ramushin, Selimin e këta haptazi. Edhe gjithçka ishte e errët. Nuk kishe se ku del, ku kishe harmoni, nuk kishe dashni. Edhe nëse ke dalë n’qytet m’u ka dokë qyteti shumë i zyrtë, po kom dalë për hirë të fëmive me i shëtitë.

Korab Krasniqi: E kur ka nisë kështu tamon lufta, ku jetnat e qytetarëve kanë fillu me u kërcnu, vrasje ka pasë gjithandej. Ju jeni konë në Mitrovicë apo?

Alije Gashi Tmava: Po, po, në Mitrovicë kom qenë deri me 3 prill, 1999, kur na dëbun prej shtëpive. Me 3 prill e kom shkelë Maqedoninë, në Dibër të Maqedonisë kom qenë. Ato kanë qenë shumë të randa. Une e thashë, kur filloi Rambujeja mendojshim që do t’bahet ni zgjidhje me u ndalu këto vrasje që kenë. Po ajo nuk përfundoi, nuk deshën dialog këta edhe fillunë vrasjet. Po si jo vrasjet. Unë thashë me 26 shkurt në front më osht’ vra vllau vet i dyti edhe ni shok i ka pshtu ma të keqës. Kështu që, gjithçka ishte e errët. Mandej me 24 mars i morën Radio Televizionin i morën krejt, na morën pushtetin, na uzurpoi. Ma s’kishim qasje as në mjete të informimit, as kurgjo. Vetëm...

Korab Krasniqi: E në Maqedoni sa keni qëndru?

Alije Gashi Tmava: Prej 3 prillit deri, tre muj thuajse se.

Korab Krasniqi: Jeni konë me djemtë edhe...

Alije Gashi Tmava: Me familje, po, po.

Anita Susuri: E qysh ka ndodhë qajo që ju kanë largu prej shpisë? Kanë qenë forcat ushtarake apo policore?

Alije Gashi Tmava: Policore, ushtarake krejt e shërbimeve sekrete krejt. Se kur e ki edhe ni njollë n'qytet osht' shumë vështirë a, se p'i kërkonin me ia marrë kokën se ka qenë një irredentist, ni UÇK, edhe nuk i kem ra n'dorë, se m'i ra n'dorë na kishin masakru. Vvdekja me plumb është e pastërt, po me t'masakru osht' e randë.

Anita Susuri: E qysh ka qenë ai udhëtimi deri në Mitrovicë? Asi, m'falni, prej Mitrovicës deri në Maqedoni?

Alije Gashi Tmava: Po, gjithçka duhet me vendosë kështu. Autobusat shkojshin, po s'dishin se ku po shkojnë. Hajt hypëm me shku në Maqedoni. Aty ish bo, me 27 mars prishtinalitë që dulen me tren aty ishte bo kijamet ish bo. Mandena nëpër binarë të hekurudhës thanë që osht' e minume. Hynëm aty me ni vend te dogana, mandej hypëm nëpër autobusa u shpërndamë. Thashë e kishim ni lidhje me këta të Maqedonisë të Dibrës erdhën në Tetovë na murrën, shkum. U vendosëm tre muj qaty deri sa përfundoi lufta.

Korab Krasniqi: Qysh e përjetut shlirimin e Kosovës, të Mitrovicës ma saktësisht?

Alije Gashi Tmava: Une, se e kishim ofertën me dalë jashtë n'viset e treta që thojshin, po nuk e kem deshtë gyrbetin kurrë niherë. Qito rrethana qysh kem qenë. Ka qenë shumë gzim, po kur u kthymë gjithçka ishte djegur. Aty n'shpi bile te baba rrymën e kishin lonë që kur t'hyjnë njerëzit aty rryma me na djegë krejt. Po fati, fëmitë jonë çdo herë shkojnë ku jonë sherret qysh me thonë. Tha, "Oj nanë, kqyrë more flakë aty", ato rrymë aty krejt qishtu të trasha {e shpjegon me duar formën}, krejt kuq, i kom largu. Në atë moment po kalon KFOR-i edhe po thom, "A ka mundësi me ardhë me shiqu ktu?" Tha, "Mos hyni" tha, edhe e qitën shiritat, "e ndalume se ktu ka rrezik për jetë". E qishtu mandena i kanë largu KFOR-i.

E janë këto gjana e krejt, po prap ëe murrëm vetën e i bonëm e i ndërtum e krejt. Po njerëzit që sot ende janë t'pagjetur, se unë e përfaqësoj edhe organizatën e dëshmorëve këtu në Mitrovicë qe 23 vite. E sot kena edhe dëshmorë që s'janë gjetë ende, kena edhe të pagjetur ende, se këto gjanat që blehen ato vet njeriu i krijon, vet i bon.

Anita Susuri: Mas luftës, ju thatë që nuk jeni kthy direkt në Trepçë, në administratë...

Alije Gashi Tmava: Jo, jo. Kom punu n'qit organizatën për zgjedhjet e para në Kosovë. Faktikisht e kom kry ni fakultet të demokratizimit, ka qenë shumë e mirë deri 2006-ën. Kom punu në ACTED, në fillim me 29 qershor jom kthy në Kosovë, me 1 korrik kom fillu me punu në ACTED. Mandej prej atyhit kalova n'qit organizatën. Ka qenë ni organizatë shumë e mirë që kom msu shumë prej saj edhe si shqiptarë zgjedhje nuk kem pasë, njerëzit nuk kanë përjetu zgjedhjet qysh kanë qenë.

Unë kom përjetu n'atë sistem, po ose voto ose mos voto ata e bojshin t'vetën, a po e din. Edhe ka qenë shumë e mirë, se kurrë niherë s'kanë dashtë shqiptartë me votu vet. Po m'kujtohet ni rast i thashë asaj amerikanës, "Po në vendvotime duhet me valu flamuri jonë, se veç na po votojna", tha, "Po bre", tha, "po nuk bon ashtu", thashë, "Qe minoritetet tjera po e bojkotojnë, nuk dojnë me dalë n'zgjedhje". E mandena qishtu, tha, "Jo, jo, nuk bon ashtu", thashë, "Ani".

Anita Susuri: E qysh u bo që erdhët prapë në administratë të Trepçës?

Alije Gashi Tmava: U ktheva prapë se thashë, thojnë, "Ku osht' hjekë duvaku osht' meraku", edhe unë u ktheva në Trepçë se kom kujtime t'mira, i kom kujtimet them t'mira, për mu e kom pasë fatin m'i kalu krejt këto shkallë, a po din, edhe tash kur t'i kujtoj e kom ni nostalgji. Edhe n'vend si Trepça, thashë, jom pak lokaliste e du Mitrovicën, e du Trepçën.

Anita Susuri: Cilin vit u bo që u kthytë?

Alije Gashi Tmava: 2009-tën jom kthy, 2009 se kom punu me këto organizatat tjera.

Anita Susuri: Kisha dashtë veç edhe niherë me u kthy te greva se mbetë ni pyetje që m'u kujtu. Ju thatë që keni bo llogaritjen e invaliditetit, a e keni bo edhe në grevë, për shembull, që ka pasë kështu smundje...

Alije Gashi Tmava: Jo, jo, apsulut. Gjithçkafi e ka pasë atë, gjithçkafi ka përfundu, ka shku teposhtë mo, s'u interesu askush për puntortë se udhëheqja ka qenë e tyne, s'ka qenë e jona, nuk u interesu ma kërkush.

Korab Krasniqi: Gjatë '90-tave kur domethonë kanë fillu edhe organizimi sindikalist i puntorëve të Trepçës ose që janë largu prej punëve, a keni qenë e përfshime n'kto aktivitete?

Alije Gashi Tmava: Ne i kena pasë sa ishim n'punë ni orë bojshim n'krye me Hajrullah Goranin, në të vërtetë, gjysë ore para ndërtesës dilshim bojshim solidarizim, po disa dilshin, disa s'dilshin qishtu. Edhe atëherë domethonë nuk kanë qenë, kena pasë njerëz që t'kanë vëzhgu prej dritarës, "Pse po del?" Qishtu.

Anita Susuri: Nëse doni edhe diçka me shtu, nëse keni diçka që ju kishit pasë qef me nda që mendoni që osht' e rëndësishme?

Alije Gashi Tmava: Faleminderit prej juve shumë që keni gjetë kohë, unë faleminderit, jom e privilegjume. Faleminderit shumë, ishte kënaqësi edhe prej juve që m'u dha mundësia m'i kujtu ato vitet rinore. Se thashë edhe niherë ndoshta tash ni javë ditë s'kisha qëndru atje në minierë pa dritë e kështu. Po pleqtë kanë thanë, "Gjithçka osht' me kohë".

Anita Susuri: Faleminderit edhe juve, ishte kënaqësi.

Alije Gashi Tmava: Faleminderit!